



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:257253
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05618600

C-IV-14-1140

Ankuesi

B E, fshati G, Prizeren.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren Ganimete Puka, me 25 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. NDERPREHET procedura ne ketë çështje juridike për shkak të vdekjes të paditësit ankuesit B E, nga fshati G, komuna e Prizrenit.

II. PROCEDURA do të vazhdoi pasi që trashëgimtarët të ndërmarrin procedurën ose kur gjykata i thërret ta bëjnë këtë sipas propozimit të palës së kundërt.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 shkurt. 2014, ankuesi përmes postes parashtrij ankesë për rishikimi të vendimit të lëshuar nga AL, me të cilin vendi ju është refuzuar kërkesa për kompensimin për ndërprerje të parakohshëm të kontratës së punës në shumën prej 600.00€. Ankesës nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë në mbështetje të ankesës së tij.

Me 22 shkurt 2024, gjykata lëshoj për ankuesin urdhër, duke e njoftuar ankuesin se nëse nuk i dorëzon provat në mbështet të ankesës, ankesa do të refuzohet në mungesë të provave, që rezulton nga konstatimet e postieri dt.13.03.2024 dhe 04.04.2024, se pala- marrësi ka vdekur.

Nga data 11. Prill. 2024, deri me 19 prill 2024, gjykata urdhrin e ka publikuar në tabelën e shpalljes.

Arsyetimi ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), që përcakton së nëë interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore

Neni 95. 1, i LPK, parasheh së me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe prokura të cilën ai e ka dhënë.

Gjykata, pas vlerësimit të shkesave të lëndës , me konkretisht nga konstatimet e postierit dt. 13.03.2024 dhe 04.04.2024, se marrësi ka vdekur, dhe duke ju referuar dispozitës ligjor të lartcekur, në rastin konkret janë plotësuar kushte ligjor komfor nenin 95.1 , si dhe nenit 277 paragrafi 1 pika a), të Ligjit për procedurën kontestimore, e lidhur me nenin 18, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligji nr.04/L-118, se procedura duhet të ndërpritet.

Procedura mund të vazhdoj në kuptim të dispozitave të nenit 280 par 1, të LPK , pasi trashëgimtarët e paditëses do ta marrin për sipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë me propozimin e palës kundërshtarë.

Nga arsyet e lartcekur, u vendos sikur në dispozitave , të këtij aktvendimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e lidhur me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohet taksa gjyqësore për ankesë.

Këshilla juridike :Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e:

Ganimete Puka